



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 257, Datë 02.12.2024

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “3AD ENERGY” SH.P.K. PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5, pika 1, gërma “a”, dhe 10, pikat 1 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 02.12.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2415/1prot., datë 21.11.2024, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë “3AD Energy” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “3AD Energy” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2415 prot., datë 18.11.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik, me kapacitet prodhues 2 MW, me vendndodhje në Zonën Kadastrale nr. 3358, Fshati Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier.
- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të Aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9 për pikën 1.1, gërmat “a” “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3 gërmat “b” dhe “c”; për pikën 2.1 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e” dhe “f”.
- Rezulton se shoqëria “3AD ENERGY” sh.p.k.:
 - Ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Kontratën nr. 2314 rep., nr. 876 kol., datë 08.07.2024 “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 2 MW, dhe

veprave ndihmëse, në Zonën Kadastrale nr.3358, Fshati Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier”;

- Ka depozituar shkresën e shoqërisë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” (OSSH) sh.a., nr. 9512/3 prot., datë 13.10.2023, për miratimin e pikës së lidhjes së centralit me rrjetin e shpërndarjes;
- Është pajisur me Vendim për VNM Paraprake, lëshuar më 07.12.2023 nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për të zhvilluar projektin “Ndërtimi i centralit fotovoltaik 3 AD SOLAR, 2 MW”. Kjo VNM është aktualisht e vlefshme (deri më 07.12.2025), dhe në kuadër të fillimit të zbatimit në terren të projektit, shoqëria ka informuar se ka aplikuar për t’u pajisur me lejet përkatëse.

- Nga ky aplikim nevojitet të plotësohet dhe sa vijon:

NENI 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1, Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- **gërma “a”**: Shoqëria duhet të depozitojë vërtetim që nuk ka detyrime të pashlyera ndaj organeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, duke iu referuar periudhës deri në 1 muaj para aplikimit.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “3AD Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet prodhues 2 MW, me vendndodhje në Zonën Kadastrale nr. 3358, Fshati Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier, për një afat 30-vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “3AD Energy” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI